



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 172 Prot

Tiranë, më 10.02.2020

V E N D I M

Nr. 11, datë 10.02.2020

**“Mbi përfundimin e verifikimit të ligjshmërisë në lidhje me transferimin e
përkohshëm të nëpunës *****”**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të verifikimit të informacionit të marrë nga kërkesa e nëpunës *****,

Vërej se:

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr.1728 prot., datë 11.12.2019, nëpunësja ***** ka parashtruar pretendimin se, transferimi i saj i përkohshëm në pozicionin “Specialist në Sektorin e Mbikëqyrjes së Vlerës Doganore”, në Drejtorinë e Politikave të Vlerësimit Doganor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, është bërë në kundërshtim me parashikimet ligjore që kanë të bëjnë me transferimin e përkohshëm të nëpunësit civil.

Nga tërësia e dokumentacionit të administruar për këtë rast, konstatohet se, punonjësja ***** është nëpunëse civile, status të cilin fillimisht e ka fituar në pozicionin “Specialist hetues”, në Drejtorinë e Hetimit Doganor, me fillimin e efekteve të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, kur Drejtoria e Përgjithshme e Doganave u përfshi tërësisht në shërbimin civil.

Vendimi nr. 9, datë 11.1.2017, i Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 921, datë 29.12.2014, “Për personelin e administratës doganore”, ndryshoi rregjimin e trajtimit të marrëdhënieve të punës për punonjësit e Drejtorisë së Hetimit Doganor, duke përcaktuar se, pas kësaj, këto marrëdhënie do të rregullohen nga dispozitat e Kodit të Punës.

Mbi këtë bazë, veprimi Komisioni i Ristrukturimit, i cili me aktin nr. 10244, datë 26.4.2017, ka vendosur, veç të tjerave, përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për punonjësen ***** dhe vijimin e marrëdhënies së punësimit me kontratë pune.

Më pas, rezulton se, me anë të aktit nr. 19481, datë 27.8.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, është urdhëruar transferimi i përkohshëm i nëpunëses në fjalë, në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Ankimimeve*”, në Drejtorinë Juridike, pranë DPD, pozicioni i cili është pjesë e shërbimit civil.

Transferimi në këtë rast, është veprim i rregullt, pasi është kryer brenda periudhës dy vjeçare që parashikon pika 8/b, e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, sipas të cilit, *nëpunësit civilë që janë larguar nga shërbimi civil si pasojë e ristrukturimit, kanë të drejtë që, brenda periudhës 2-vjeçare pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil...b) të emërohen në mënyrë të përkohshme nga njësia përgjegjëse, me pëlqimin e tyre, në pozicione të shërbimit civil.*

Gjithashtu konstatohet se, akti ka dalë nga organi kompetent, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, siç parashikon pika 17, Kreu V, “*Transferimi i përkohshëm*”, e Vendimit nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për personelin e administratës doganore*”, i ndryshuar, dalë në zbatim të ligjit 102/2014, “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, të ndryshuar, sipas të cilit, transferimi i përkohshëm i punonjësit doganor, për shkaqet e parashikuara në kodin doganor, bëhet nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave.

Nga aktet e administruara, rezulton se, transferimi i përkohshëm për këtë punonjëse ka vazhduar, pasi, për nevojë të institucionit është transferuar përsëri në pozicionin “*Specialist Jurist/Borxhi në Zyrën e Administratës*”, në Degën Doganore Durrës (akti nr. 29626/1, datë 21.12.2018) dhe nga ky pozicion, për shkak ristrukturimi, me aktin nr. 7185, datë 23.3.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, është emëruar në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Administratës dhe Shërbimit*”, Dega Doganore Tiranë.

Transferimi në këtë rast, është kryer sipas rregullave që parashikon ligji nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe pikës 8, të nenit 15, të Kodit Doganor. Në këtë moment, kjo punonjëse, për shkak të emërimit të saj të përhershëm (pas kryerjes së ristrukturimit), në një pozicion pune të shërbimit civil, brenda afatit 2-vjeçar që parashikon ligji për nëpunësit e larguar për shkak ristrukturimi, ka rifituar statusin e nëpunësit civil.

Më pas, me aktin nr. 13147, datë 28.5.2019, për nevojë të institucionit, ajo është transferuar, nga pozicioni i mësipërm në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Mbikëqyrjes së Vlerës Doganore*”, Drejtoria e Politikave të Vlerësimit Doganor (ku punon aktualisht), akti i cili, është kundërshtuar nga kjo punonjëse, pranë titullarit të institucionit, për shkak të pretendimeve të saj si akt i dalë në kundërshtim me ligjin.

Në kushtet kur institucioni nuk ka reaguar, si dhe e ndodhur në përfundim të afatit 6-mujor, si afat maksimal që përcakton ligji në rastin e transferimit të përkohshëm, punonjësja në kërkesën e saj, ka ngritur pretendimin për kthimin në vendin e mëparshëm të punës si *“Specialist në Sektorin e Administratës dhe Shërbimit”* Dega Doganore Tiranë, atje ku ajo ka marrë emërimin e fundit, pas ristrukturimit të institucionit.

Transferimi i përkohshëm i punonjësve doganorë, pjesë e shërbimit civil, bëhet sipas rregullave të kodit doganor dhe konkretisht, në pikën 7, të nenit 15, të këtij kodi, në shkronjën “a” përcaktohet: *“Punonjësi doganor mund të transferohet, përkohësisht, në një pozicion tjetër të administratës doganore, të së njëjtës kategori, apo në një kategori më të lartë, për këto arsye dhe kohëzgjatje:*

i)në interes të institucionit, deri në 6 muaj...., dhe më tej, në shkronjën “c”, parashikohet: “Në përfundim të afatit të transferimit, nëpunësi kthehet në pozicionin e mëparshëm, me përjashtim të rasteve kur nëpunësi pranon të vijojë në pozicionin ku ishte transferuar”.

Nga sa më sipër, nisur nga përmbajtja e aktit objekt shqyrtimi, rezulton se, ai ka dalë në përputhje me përcaktimet ligjore, duke ruajtur kategorinë e pagës (*kategoria C1*), si dhe përcaktimin e kohëzgjatjes deri në 6 muaj. Në lidhje me pretendimin e punonjësës se, në akt nuk është shënuar afati 6-mujor i transferimit të përkohshëm, konstatohet se, pavarësisht se institucioni formalisht nuk është shprehur në lidhje me kohëzgjatjen e transferimit, realisht, baza ligjore e cituar në akt, parashikon pikërisht transferimin, për nevoja të institucionit, deri në 6 muaj.

Ndërkohë, konstatohet që megjithëse afati 6-mujor i transferimit ka përfunduar (*në datën 30.11.2019*) si dhe në kushtet kur nuk kemi të bëjmë me ndonjë rast përjashtimor që parashikon ligji, nga ana e institucionit nuk është reaguar, prandaj, me të drejtë kjo punonjëse, kërkon ndërhyrjen e Komisionerit për kthimin në pozicionin e mëparshëm të punës, sikurse parashikojnë dispozitat ligjore. Për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë në këtë rast, duhet që Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, të nxjerrë aktin përkatës për rikthimin e punonjësës ***** në pozicionin e punës *“Specialist në Sektorin e Administratës dhe Shërbimit”*, Dega Doganore Tiranë.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, si dhe në nenet 16 dhe 35, të Rregullores, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të kërkoj nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, të nxjerrë aktin administrativ për kthimin e nëpunëses ***** në pozicionin e mëparshëm të punës, si “*Specialist në Sektorin e Administratës dhe Shërbimit*”, Dega Doganore Tiranë, për shkak se është tejkaluar afati maksimal 6-mujor i transferimit, parashikuar në pikën 7, të nenit 15, të ligjit 102/2014, “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, të ndryshuar.
2. Për kryerjen e veprimeve administrative, lihet afat **10** ditë, nga marrja dijeni për këtë vendim.
3. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse është e detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
4. Në rast të mos respektimit të këtij vendimi, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve që nuk kanë kryer detyrimet e lëna në këtë vendim dhe në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljes së konstatuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
5. Të njoftohen për këtë vendim, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe njësia e burimeve njerëzore të institucionit, si dhe nëpunësja *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha